

*Specialist/Sektori i Politikave të Sigurisë Kibernetike dhe Çështjeve Ligjore, Drejtoria e Certifikimit, Politikave e Legjislacionit të Sigurisë Kibernetike, në Autoritetin Kombëtar për Sigurinë Kibernetike.*

Në zbatim të ligjit nr. 9880, datë 25.02.2008 “Për nënshkrimin elektronik”, i ndryshuar, ligjit nr. 107/2015 “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”, i ndryshuar, ligjit nr. 25/2024 “Për Sigurinë Kibernetike”, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 783 datë 18.12.2024 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe punonjësve në disa institucione të administratës publike”, i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 482, datë 24.07.2024 “Për përcaktimin e masës së shtesës për natyrë të veçantë pune për drejtorin e përgjithshëm dhe nëpunësit në njësitë teknike të përmbajtjes së Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike”, urdhrin të Kryeministrit nr. 239, datë 16.12.2024 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike”, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike shpall konkurrimin për 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin:

- **Specialist/Sektori i Politikave të Sigurisë Kibernetike dhe Çështjeve Ligjore, Drejtoria e Certifikimit, Politikave e Legjislacionit të Sigurisë Kibernetike, në Autoritetin Kombëtar për Sigurinë Kibernetike.**

#### **DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E POZICIONIT PËRMBAJNË POR NUK KUFIZOHEN NË:**

- Zbaton me korrektësi aktet ligjore dhe nënligjore, që përcaktojnë dhe rregullojnë objektin e veprimtarisë së sektorit apo detyrës së ngarkuar;
- Përgjigjet për hartimin e dokumenteve strategjike, adaptimin e standardeve ndërkombëtare, hartimin e rregulloreve, si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fushën e certifikimit elektronik dhe sigurisë kibernetike, sipas nevojave të planifikuara të institucionit;
- Kontribuon në hartimin e legjislacionit të fushës së identifikimit elektronik, shërbimeve të besuara, dhe sigurisë kibernetike në përputhje me Acquis e BE-së;
- Jep kontribut në trajtimin e çështjeve të ndryshme ligjore, që prekin fushën e veprimtarisë së institucionit;
- Ndjek proceset gjyqësore ku Autoriteti është i përfshirë, duke e përfaqësuar atë në të gjitha shkallët e gjykimin;
- Kryen detyrën e ngarkuar brenda afatit të përcaktuar nga përgjegjësi i sektorit, drejtori i drejtorisë apo Drejtori i Përgjithshëm.

#### **KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT**

**Arsimi:** Niveli minimal i diplomës “Master Profesional”, në Shkenca Juridike. Edhe diploma “Bachelor” të jetë në të njëjtën fushë.

**Përvoja:** Të ketë jo më pak se 1 vit përvojë pune në profesion.

## **FUSHA E NJOHURIVE:**

Kandidatët do të intervistohen mbi fushën e njohurive si më poshtë:

- Ligjin nr. 9880, datë 25.02.2008 “Për nënshkrimin elektronik”, të ndryshuar;
- Ligjin nr. 107/2015 “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”, të ndryshuar;
- Ligjin nr. 25/2024 “Për Sigurinë Kibernetike”;
- Specialitete brenda fushës së caktuar profesionale.

Aftësi për të:

- Integruar politikat e sigurisë kibernetike në akte ligjore dhe nënligjore dhe qartësuar çështje e dhënë mendime alternative të mbështetura në përvojë;
- Hartuar akte ligjore dhe nënligjore të fushës së sigurisë kibernetike;
- Analizuar, komunikuar, prezantuar, si dhe për të pranuar metoda dhe procedura të reja;
- Përbën avantazh pajisja me certifikata apo dëshmi të tjera në fushën e sigurisë kibernetike dhe shërbimeve të besuara;
- Të njohë mirë gjuhën angleze.

Çdo kandidat jo-kualifikues pas procesit të intervistës, ka të drejtë për ankim jo më vonë se 2 (dy) ditë kalendarike pas marrjes së njoftimit.

## **PAGA PËR POZICIONIN ËSHTË NË KLASËN (IV-1)**

### **PARAQITJA E DOKUMENTEVE:**

Kandidati duhet të dërgojë brenda datës 18.02.2025, në Autoritetin Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, në adresën: Rruga “Papa Gjon Pali II”, Nr. 3, Kati I, Tiranë ose në adresën e e-mailit: [burimet.njerezore@aksk.gov.al](mailto:burimet.njerezore@aksk.gov.al), këto dokumente:

- Kërkesë për aplikim;
- CV (sipas formatit europass në gjuhën shqipe);
- Fotokopje të diplomave që disponon dhe listës së notave;
- Diplomat e përfunduara jashtë vendit duhet të shoqërohen edhe me dokumentin e njohjes nga institucionet përkatëse, sipas legjislacionit të arsimit të lartë;
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje të certifikatave të kualifikimit (nëse ka);
- Fotokopje të dëshmive të gjuhëve të huaja;
- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- Të paktën një letër rekomandimi.

Mosparaqitja e plotë dhe brenda afatit e dokumenteve sjell skualifikim të kandidatit.